



Agjencia e Mbikëqyrjes Policore

NËNTOR 2022

Agjencia ka marrë masa dhe ka siguruar kushtet për të zbardhur dhe administruar ankesat e ardhura në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga publiku, si dhe ankesa e shqetësime të adresuara nëpërmjet institucioneve të tjera të administratës publike apo nga media vizive dhe ajo e shkruar.

Të gjitha ankesat e reja regjistrohen në Sistemin e Menaxhimit të Çështjes, për t'u ndjekur në vijim, në kohë reale, në përputhje me ligjin dhe procedurat standarde të punës për trajtimin e ankesave.

MËNYRAT E KOMUNIKIMIT ME QYTETARËT

Për ankesa ndaj strukturave objekt i veprimtarisë




ankesa@amp.gov.al



0800 90 90

Për denoncime në kuadër të Vetingut në Polici



denonco@amp.gov.al



Rr. "Asim Vokshi", Nr. 19/1, Tiranë


Për t'u paraqitur në zyrat tona



Zyra e Pritjes së Qytetarëve në
Drejtorinë e Përgjithshme

Zyrat e Drejtorive Rajonale pranë
DVP-ve në Qarqe

Për t'u informuar rreth AMP, na ndiqni



www.amp.gov.al



VEPRIME HETIMORE

Referimet e bëra në Prokurori

12 referime në Prokurori për **12** punonjës të Policisë së Shtetit dhe **5** shtetas për vepra të ndryshme penale.

Arrestuar/ndaluar në flagrancë

1 punonjës policie dhe **1** shtetas të arrestuar në flagrancë

Ekzekutimet e vendimeve të dhëna nga Prokuroria/Gjykata

- Vendosur masa e sigurimit "Arrest në burg": **2** punonjës policie dhe **5** shtetas
- Vendosur masa e sigurimit "Arrest në shtëpi": **1** shtetas

INSPEKTIVE/VENDIME

Gjatë muajit Nëntor janë kryer **6** inspektive nga të cilat ka rezultuar se në **3** raste veprimet e punonjësve subjekt i Agjencisë kanë qenë në kundërshtim me kuadrin ligjor. Pas analizimit dhe vlerësimit është rekomanduar:

1. Fillimi i hetimit disiplinor për shkelje të rëndë për **4** punonjës nga Komisioni Disiplinor i Agjencisë.
2. Fillimi i hetimit disiplinor për shkelje të lehtë për **2** punonjës nga Policia e Shtetit.

Gjithashtu, në kuadër dhe për zbatimin e ligjit të AMP, Komisioni Disiplinor ka shqyrtuar në total 13 praktika disiplinore, nga të cilat në 2 raste komisioni ka konstatuar dhe ka vendosur për shkelje të lehtë disiplinore ndaj **2** punonjësve duke ja kaluar DPPSH për ndjekje e kompetencë, ndërsa në 11 raste komisioni ka konstatuar dhe ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor ku në përfundim të verifikimeve ka rezultuar:

- Në 3 raste, për **4** punonjës ka shkelje të rëndë disiplinore për të cilët komisioni ka vendosur Për Përfundimin nga Policia e Shtetit
- Në 4 raste, për **4** punonjës ka shkelje të rëndë disiplinore për të cilët komisioni ka vendosur;
 - a) "Shtyrje të afatit të gradimit deri në 2 vite" për 2 punonjës
 - b) "Shtyrje të afatit të gradimit deri në 6 muaj" për 2 punonjës
- Në 1 rast, për **3** punonjës, ka shkelje të lehtë disiplinore për të cilat komisioni ka vendosur "Përfundimin e hetimit disiplinor" dhe rekomandimin e praktikës në DPPSH
- Në 3 raste, për **5** punonjës, nuk ka shkelje të rëndë disiplinore për të cilat komisioni ka vendosur "Përfundimin e hetimit disiplinor", raste për të cilat punonjësit e policisë janë duke u ndjekur penalisht nga strukturat përkatëse.

HETIME ADMINISTRATIVE TË ANKESAVE

Zyra e pritjes së qytetarëve dhe komunikimi me publikun




324 Telefonata

në linjën e gjelbër **08009090**, nga të cilat:

149 telefonata brenda objektit të veprimtarisë së AMP
(Në ndjekje nga strukturat përgjegjëse të Agjencisë)

58 telefonata jashtë objektit të veprimtarisë së AMP
(Adresuar strukturave të administratës publike për ndjekje)

117 telefonata i është dhënë informacioni sipas rastit
(Qytetarët janë orientuar drejt strukturës kompetente të administratës publike që trajton ankesat e tyre)



Ankesa të trajtuara

Ky grup nënkupton përfundimin e trajtimit të ankesës dhe kthimin e përgjigjes për qytetarin.

148 ankesa



Ankesa të administruara

Administrimi nënkupton regjistrimin e çdo ankese, pavarësisht nëse duhet të ndiqet nga Agjencia apo një institucion tjetër i Administratës Publike. Ankesat administrohen në Sistemin e Menaxhimit të Ankesave, ku secila merr një numër unik.

92 ankesa